

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenit 65 të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/03 prill 2017) dhe nenin 4, paragrafi 3, nenin 60, nenin 61 dhe nenin 62 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2025, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR LLOGARITJEN E KUFIRIT MINIMAL TË AFTËSISË PAGUESE, ADEKUATSHMËRISË SË KAPITALIT DHE FONDIT GARANTUES PËR SIGURUESIT JO-JETË

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është të plotësojë dhe ndryshojë Rregulloren për llogaritjen e kufirit minimal të aftësisë paguese, adekuatshmërisë së kapitalit dhe fondit garantues për siguruesit jo-jetë e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më datë 30 maj 2019 (më tutje: rregullorja bazë).

Neni 2

1. Neni 2 paragrafi 1 i rregullores bazë, pas nënparagrafit 1.10 shtohet nënparagrafi 1.11 si në vijim:

1.11 Pasuritë e riposeduara - janë hipotekat (në rastet e pasurive të paluajtshme) apo pengu (në rastet e pasurive të luajtshme) të cilat siguruesi i ka përdorur si kolateral (instrument të sigurisë) me rastin kontraktimit të një mbulese siguruese dhe për të cilat pasuri siguruesi e fiton të drejtën e pronësisë sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 3

1. Numërimi i nënparagrafëve të paragrafit 2 të nenit 6 të rregullores bazë, në atë mënyrë që numërimi nga 1.1 deri 1.13 i nënparagrafëve ndryshohet në 2.1 deri në 2.14.

2. Neni 6 paragrafi 2 nënparagrafi 2.8 (sipas numërimit nga paragrafi 1 i këtij neni) i rregullores bazë ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

2.8. Toka, ndërtesa dhe pajisjet siç definojnë me SNK 16 Prona, Fabrika dhe Pajisjet dhe të aseteve me të drejtë përdorimi siç definojnë me SNRF 16 Qiratë e pronës/objekteve të cilat përdoren si hapësirë e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të tij biznesor, për ofrimin e shërbimeve dhe për qëllime administrative të cilat:

2.8.1. nuk janë të regjistruara ose e noterizuar në emër të siguruesit;

- 2.8.2. prona nuk janë të regjistruara në libra sipas vlerës të përcaktuar mbi bazën e vlerësimit të vlerësuesit të licencuar në Republikën e Kosovës dhe Rregullores së BQK-së për vlerësimin e pasurive të paluajtshme;
- 2.8.3. janë lënë hipotekë si dhe nuk janë të lira nga çdo barrë tjetër. Këto asete do të konsiderohet të zbritshme deri në nivelin që pronat mund të lejohen të llogariten kundrejt obligimeve që ato mbulojnë.
- 2.8.4. tejkalojnë 75% të kapitalit bazë. Pjesa e vlerës së bartur mbi 75% të kapitalit bazë do të zbritet prej kapitalit. Në rrethana që e arsyetojnë një përqindje më të lartë se 75% të kapitalit bazë sipas vlerësimit të BQK-së, BQK mund të lejoj përjashtim deri në 100% të kapitalit bazë deri në 3 muaj. Për këto raste siguruesi duhet të kërkoj miratim paraprak nga BQK-ja.
- 2.8.5. të cilat janë bërë pa aprovimin paraprak të BQK-së duke përjashtuar pasuritë të cilat definohet me SNRF 16 – Qiratë, për të cilat nuk kërkohet aprovim paraprak nga BQK.
3. Neni 6 paragrafit 2 nënparagrafi 2.9 (sipas numërimit nga paragrafi 1 i këtij neni) i rregullores bazë ndryshohet si në vijim:
- 2.9. Asetet e marra në riposedim si në vijim:
- 2.9.1. 25 % të tokës, ndërtesës dhe të drejtave në asete të paluajtshme që janë marrë në riposedim për shlyerjen e detyrimeve ndaj kontratave të sigurimit dhe që mbahen nga siguruesi për më shumë se 3 muaj por me pak se 6 muaj dhe që nuk përdoren si hapësirë e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të tij biznesor, për ofrimin e shërbimeve dhe për qëllime administrative.
- 2.9.2. 50 % të tokës, ndërtesës dhe të drejtave në asete të paluajtshme që janë marrë në riposedim për shlyerjen e detyrimeve ndaj kontratave të sigurimit dhe që mbahen nga siguruesi për më shumë se 6 muaj por me pak se 9 muaj dhe që nuk përdoren si hapësirë e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të tij biznesor, për ofrimin e shërbimeve dhe për qëllime administrative.
- 2.9.3. 75% të tokës, ndërtesës dhe të drejtave në asete të paluajtshme që janë marrë në riposedim për shlyerjen e detyrimeve ndaj kontratave të sigurimit dhe që mbahen nga siguruesi për më shumë se 9 muaj por më pak se 12 muaj dhe që nuk përdoren si hapësirë e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të tij biznesor, për ofrimin e shërbimeve dhe për qëllime administrative.
- 2.9.4. 100% të tokës, ndërtesës dhe të drejtave në asete të paluajtshme që janë marrë në riposedim për shlyerjen e detyrimeve ndaj kontratave të sigurimit dhe që mbahen nga siguruesi për më shumë se 12 muaj dhe që nuk përdoren si hapësirë e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të tij biznesor, për ofrimin e shërbimeve dhe për qëllime administrative.
- 2.9.5. 50 % e aseteve të luajtshme që janë marrë në riposedim për shlyerjen e detyrimeve ndaj kontratave të sigurimit dhe të cilat janë mbajtur për shitje për më shumë se 3 muaj por më pak se 6 muaj.
- 2.9.6. 100 % e aseteve të luajtshme që janë marrë në riposedim për shlyerjen e detyrimeve ndaj kontratave të sigurimit dhe të cilat janë mbajtur për shitje për më shumë se 6 muaj.

4. Në neni 6 paragrafit 2 shtohet nënparagrafi i ri me numër 2.10 me përmbajtje si në vijim:
 - 2.10. Pronat Investuese siç përcaktohet me SNK 40 Pronat Investuese duke përjashtuar SNRF16 Qiratë, të cilat janë bërë pa aprovim paraprak të BQK-së, ose të cilat përmbushin kërkesat e përcaktuara sipas nenit 3, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.8.1, 2.8.2 dhe 2.8.3 të kësaj rregullore si dhe pjesa që tejkalon 15% e kapitalit bazë.
5. Numërimi i nënparagrafëve nga 2.10 deri 2.13 (sipas numërimit nga paragrafi 1 i këtij neni) të nenit 6 paragrafi 2 të rregullores bazë, ndryshohet në numërimin nga 2.11 deri 2.14.

Neni 4

Dispozita kalimtare

Për pronat tashmë të njohura si kapital nga siguruesit dhe të aprovuara nga BQK para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të cilat shkaktojnë ndryshime në strukturën dhe adekuatshmërinë e kapitalit duke rezultuar në mungesë kapitali, periudha e përshtatjes me kërkesat e kësaj rregulloreje, sipas paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 3, do të zgjasë deri më 31 mars 2026.

Neni 5

Hyrja në fuqi

1. Të gjitha dispozitat tjera të rregullores bazë mbesin në fuqi, përveç dispozitave të ndryshuara dhe plotësuara me këtë rregullore të cilat kanë efekt nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore.
2. Kjo rregullore është pjesë përbërëse e rregullores bazë.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi me datë 1 Korrik 2025.

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës